



Prishtinë: 29 dhjetor 2009

Kodi i ZRRE-së: V\_219\_2009

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_290\_10\_09

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 14 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK\_V\_290\_10\_09
5. Apelimi i konsumatorit i datës 29.10.2009; dhe
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

**Në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2009 nxori këtë:**

### VENDIM

**REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Ajet Caka (parashtruesi i ankesës Avdyl Jusufi me shifër të konsumatorit në KEK: **DPR – 15**) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

### Arsyetimi

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK- së në ZRRE me datë 28.08.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 31.07.2009, lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Në faturën e muajit janar 2009 konsumatorit nga ana e KEK-ut i ka arritur fatura si shpenzim mujor me 1,845 kWh, apo e shprehur financiarisht në vlerë prej 158.26 €.  
**Provë:** Fatura e muajit janar 2009
- Me datë 25.02.2009 zyrtarët e autorizuar të KEK-ut kanë dalur te konsumatori me kërkesën e konsumatorit dhe kanë konstatuar se njehsori ka gjendjen në tarifën e lartë 99804 kWh dhe në tarifën e ulët 09925 kWh. Vulat shtetërore dhe distributive janë në rregull, dhe se njehsori regjistron energji vetëm në tarifën e lartë ngase ju mungon ora tarifore.  
**Provë:** Procesverbali nr. 270187 të datës 25.01.2009
- Me datë 05.02.2009 konsumatori ka parastruar ankesë në departamentin për konsumatorë në KEK duke kundërshtuar faturën e muajit janar 2009.  
**Provë:** Ankesa e konsumatori në KEK

- Me datë 03.04.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 08.10.2009 DMK e ZRRE-së ka nxjerrë vendim në lidhje me ankesën e konsumatorit ku ka refuzuar ankesën e konsumatorit lidhur me faturimin e energjisë elektrike së muajit 01/2009.  
**Provë:** Përgjigja e DMK së ZRRE-së e datës 08.10.2009
- Me datë 29.10.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, duke kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_290\_10\_09.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK\_V\_290\_10\_09 **dhe** ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së.

Apeluesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar